

# RAPORT

## Dëgjësë publike për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë

Sot, më datë 05.09.2016, në ambjentet e bibliotekës së qytetit, në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë u organizua dëgjësja publike për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Planin e Përgjithshëm Vendor.

Pjesëmarrës në dëgjësë ishin banorë nga qyteti dhe njësitë Administrative të Bashkisë Korçë, profesionistë të fushës së planifikimit dhe të ndërtimit, grupe të ndryshme interesi, përfaqësues institucionesh, përfaqësues të studios, të AKPT-së dhe **Ministrisë së Mjedisit**.

Takimi u hap me fjalën e kryetarit të Bashkisë Korçë, i cili theksoi rëndësinë e hartimit dhe më tej të miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë si një dokument, instrument bazë për një zhvillim të qendrueshëm në fushën ekonomike, të turizmit, si dhe në mbrojtjen e mjedisit.

Përfaqësuesi i studios, z. Auron Pasha parashtoi prezantimin e dy materialeve : Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Planin e Përgjithshëm Vendor.

Prezantimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor u bë nga eksperti i studios konsulente, Ing. Gjeolog Sazan Guri. Prezantimi në përmbajtje të tij kishte:

Vizionin e Bashkisë Korçë

Parimin e Planit Strategjik

Legjislacionin

Projektet e kryera dhe kërkesën për shtimin e tyre

Ndotjen e ajrit

Gjeologjia

Gjeorreziket

Ruajtja e biodiversitetit

Zonat e mbrojtura

Gjeomonumentet

Sipërfaqet e gjelbra dhe monumentet e kulturës

Asetet, si etnografia, antikiteti, veshjet popullore, monumentet arkeologjike

Ujrat e zeza

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

Trajtimi i integruar i mbetjeve

Objektivat kryesore, siç mund të jenë mbyllja dhe rehabilitimi i venddepozitimeve, ndërtimi i venddepozitimeve rajonale, etj

Energjia elektrike

Erozioni

Gjeoteknika

Aktivitetet minerale

Analiza demografike

## Analiza SWOT

Ndikimet e rëndësishme të Planit në Mjedis (analizohet me shkallët A,B,C,D,E,X)

Vlerësimi i përputhshmërisë së politikave të Planit me Objektivat Mjedisore

Ndikimet negative dhe masat për zbutjen e ndikimeve negative

Përputhshmëritë me objektivat mjedisore

Përfundime : sistemi i monitorimit. Janë dhënë mendime për tu marrë parasysh dhe rekomandime për çdo rast.





Pas prezantimit, u vijua me komente dhe pyetje të pjesëmarrësve, të cilave iu përgjigjën ekspertët e studios konsulente, specialistët e D.P.K.Zh.T dhe të AKPT.

- Një nga pyetjet e para ishte : Korça ngrohet me dru, si do të furnizohet me lëndë djegëse dhe cilat janë alternativat? Eksperti i mjedisit i studios konsulente sqaroi se vitet e fundit ka patur prerje masive të pyjeve, gjë për të cilën qeveria ka miratuar moratoriumin e pyjeve. Variantet për ngrohje dhe energji janë : biomasa që formohet nga landfill-i, vënia në punë e TEC-it (100 mega ëat) që do të bëjë kompesimin e energjisë, stazhionimi i lëndës drusoreme qëllim që djegia e saj të ketë eficensë të madhe dhe ndotje të ulët, kujdesi i njerëzve për mjedisin dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbra. Ekzistojnë projekte për fermat e erës që mund të mbahen parasysh. Gjithashtu termoizolimi i godinave ndihmon në rritjen e eficensës së energjisë. Ndërkohë, z.Pasha shtoi se një zgjidhje tjetër do të ishte krijimi i një dalje nga gazsjellësi TAP.
- Gjatë prezantimit u theksua se në lindje të tij, qyteti i Korçës do të rrethohej nga një kurore e gjelbër? Pyetje e ngritur nga një qytetar ishte : kodrat janë me pronarë, a janë marrë parasysh? Si do të gjelbërohet?

- Pyetje : Nga prezantimi, në lidhje me HEC-et u tha që norma 50 % e prurjeve do dhe duhet të mbetet e paprekshme. Me normat europiane nuk është kaq dhe në këto kushte asnjë operator nuk vepron dot. Eksperti i mjedisit i studios konsulente sqaroi se HEC-et e kanë 33 % të prurjeve ekologjike të paprekshme dhe kjo nuk diskutohet.
- Pyetje : nga prezantimi u tha që në tokat e kategorisë 1,2,3,4 nuk mund dhe nuk duhet të lejohet të ndërtohet, ndërkohë që njësi administrative Bulgarec ka pothuaj vetëm këto kategori tokash. Përgjigja e z.Pasha ishte që nuk do lejohet ndërtimi për rezidenca, por për ndërtimet e tjera është i lejueshëm.
- Pyetje : Miratimi i VSM-së e lehtëson apo do të influencojë në marrjen e miratimit të infrastrukturës mjedisore para miratimit të lejeve të ndërtimit? Mendojmë se afati i miratimit të VNM-vë paraprake është shumë i lartë. Të shikohet mundësia për uljen e afateve me qëllim lehtësimin e procedurave. Eksperti i mjedisit i studios konsulente sqaroi se nuk ndikonte, pasi për çdo leje ndërtimi duhet miratim i VNM-ve paraprake ose të thelluar.
- Nga pjesëmarrësit u bë një sugjerim ndoshta Plani duhej diskutuar në çdo njësi administrative.

Në vazhdim u kalua në prezantimin e Planit të Përgjithshëm Vendor nga ekspertja e planifikimit urban e studios konsulente, znj. Eri Çobo. Prezantimi filloi me analizën, strategjinë duke vazhduar më tej me Planin.

Po ashtu u bë një prezantim i studimit të bërë mbi sistemin rrugor, infrastrukturor nga Prof. Shkelqim Zeqo, i cili theksoi ndarjen e sistemit në : rrugë interurbane kryesore; rrugë interurbane dytësore; rrugë urbane kryesore; rrugë urbane dytësore; rrugë urbane lokale; si dhe entin përkatës i cili do të merret me administrimin e tyre.

U bë përcaktimi i **Zonave Ekonomike** si në qytet po ashtu edhe në Njësitë Administrative. Zonat janë: 1. Voskop , 2. Mollaj, 3.Drenovë, 4.Bulgarec , 5. Disnicë,

### **Strukturat e Shërbimeve**

Nga studimet e bëra rezulton se në Bashkinë Korçë ka nevojë për investimin e e 31 strukturave për çerdhe dhe kopshteve. Një ide mbi zhvillimin e tyre do të ishte ndërtimi i çerdheve dhe kopshteve në struktura të përbashkëta. Gjithashtu kërkohet dhe përmirësimi i strukturave të shërbimeve të arsimit në të shumtën e njësisve administrative.

### **Hapësira Publike**

Krijimi e tyre në Njësitë Administrative. Po ashtu rikualifikimin e atyre ekzistuese në hapësira më kualitative.

### **Sistemi Bujqësor**

Është sistemi më i rëndësishëm. Në këtë plan të përgjithshëm vendor do të synohet drejt konsolidimit të zonave informale dhe duke ruajtur zonat bujqësore, kjo do të thotë që nuk mund të ndërtohet më në tokë arë objekte me destinacion rezidencial.

### **Sistemi Urban**

Synon konsolidimin e zonave të banuara vetëm në zonat urbane si në qytet po ashtu edhe në njësitë administrative. Po ashtu prioritet do të jetë turizmi, krijimi i bujtinave.

## **Territori**

Leximi i territorit do të bëhet në bazë të njësive strukturore, ku në një njësi nuk mund të ketë 2 lloj intensiteti apo dy lloje të ndryshme koeficienti shfrytëzimi.

## **Tipologjitë e Banimit**

Në njësitë administrative do të ruajmë tashme sistemet që janë të konsoliduara apo kanë një histori duke përdorur të njëjtën sis.arkitekture, pra çdo zonë do të ketë pasaportën e njësisë që indentifikon. Lartësia e lejuar shkon deri në tre kate dhe po ashtu çdo zonë do të ketë më shumë se 1 përdorim të lejuar.

**Në brëndësi të qytetit, ndodhet** zona qendrore dhe zona historike dhe zona e mbrojtur e cila do të vazhdojë të respektojë ligjet përkatëse VKM. 238, ku tashmë do të quhet M1 (zona historike), që do të ketë vetëm riparimet e banesave ekzistuese dhe rikonstrukcionin e tyre, M2 zona e mbrojtur (ansambël) dhe M3 zona arkeologjike.

**Në zonat e reja** që propozohen për ndërtim do të aplikohet me PDV, ku do të jetë e nevojshme një plan mbi infrastrukturën publike. Intensiteti në qytet shkon deri në 3, ndërsa numri i kateve shkon deri në 8 kate.

Pas prezantimit Z.Auron Pasha fton të pranishmit të diskutojnë mbi Planin e Përgjithshëm Vendor .

**Një sugjerim nga pjesëmarrësit ishte :** Prezantimi i bërë në sallë do të kishte qënë më konkret nëse do të ishte bërë në prezencën e disa hartave apo edhe të rregullores në të cilën mund të shikonim konkretisht zona të interesuara. Po ashtu edhe sistemi i rrjetit rrugor të propozuar mund të ishte prezantuar nëpërmjet hartave.

Pyetje: Çfarë ndosh në zonat A1.2. dhe A1.3a apo dhe në zona të tjera, rrugët do të jenë po të njëjtat apo do të kemi ndryshime? Do të ketë ndryshime të intensitetit në zonat ekzistuese të qytetit? Ndërtimet në njësi të ndryshme administrative do të kenë të njëjtin intensitet?

Voskopoja ka një qëndër historike dhe një pjesë ansambël. Si do të bëhet për një banesë me 2 kate do të dërgohet në Insitutin e Monumenteve të Kulturës për miratim apo do të funksionojë si për qytetin e Korçës?

Në zonat e tjera jo ansambël, në qytet, por të tipologjisë deri në tre kate është karakteristike distanca 25 cm, si do të vazhdojë projektimi, do të parashikohen në rregulloren vendore?

Përfaqësuesi i studios vazhdoi shpjegimin duke thënë se intensiteti do të ndryshojë, s' do të jetë në çdo zonë i njëjtë, janë bërë studime të reja dhe janë rivlerësuar zonat. Në zonat e tjera jo ansambël, por të tipologjisë deri në tre kate ku është karakteristike distanca 25 cm do të parashikohet në rregulloren vendore që do shoqërojë planin, respektimi i karakteristikës së zonës, sepse janë zona karakteristike dhe meritojnë trajtim tjetër.

Voskopoja do të shyrtohet edhe me monumentet e kulturës dhe do të punohet për të arritur të njëjtin zgjidhje po ashtu si për zonën ansambël të qytetit.

Pyetje : Po për planifikimin e një stalle psh. apo e një strukture çfarëdo, do të vepohet rregullorja aktuale nr.283, apo do të kemi rregulla të percaktuara në rregulloren e propozuar për PPV.

Të pranishmit që ishin përfaqësues nga AKPT shpjeguan se rregulloret që po përdoren sot dolën si nevojë për arsye sepse në zona të caktuara nuk kishte plane. U theksua fakti se ekziston e drejta e transferimit të pronësisë që do të thotë jo kudo do të ketë stalla dhe objekte ekonomike. Mund të merret shumë mire qyteti i Lushnjes si shembull për këtë.

Propozim : Rruga Voskopojë - Vithkuq nuk është parashikuar dhe duhet vënë sepse është pjesë e unazës turistike të Korçës.

Pyetje : Jam një qytetar i interesuar se si do të zhvillohet prona në zona në belvedere. Do të merret parasysh që ka disa pronarë dhe që duan të zhvillojnë pronën apo do të bëhet vetëm për një pronar?

Përgjigja e përfaqësuesit të studios ishte që paraqitni hartën e pronës pranë Bashkisë për ta verifikuar.

Pyetje : Në aspektin ekonomik dhe kulturor nuk është konkretizuar çfarë është thënë, kam parasysh çështjen e turizmit. Nuk preket fare në këtë aspekt. Deri në çfarë faze do të trajtojë plani turizmin e zonave në Voskopojë, Dardhë etj?

Përgjigje e z. Pasha : Ka një studim mbi turizmin i bërë në bazë sistemesh. Në strategji e kemi të përcaktuar çdo element. Mund ta keni në dispozicion.

Pyetje : Një itinerar shumë i gjatë është nëse do të shkoja në qytetin e Vlorës, duhet të shkoj në Elbasan e pastaj më tej. Mendoj se ka sens të propozohet një rrugë në konceptimin e aksit perëndim – lindje.

Përgjigje e z.Pasha : Pa një justifikim ekonomik nuk mund të merret një hap i tillë, pasi mund të bëhet si propozim dhe mund të mbetet aty. Ka dhe akse të tjera. Krijimi i një sistemi ekologjik mund të sjell krijimin e një rruge. Ne mund të vendosim rrugën në formë skematike duke ndjekur dhe gjurmën e TAP-it..

Pyetje : A keni një land use mbi planifikimin e territorit ?

Përgjigje : po, kemi 14 kategori përdorimi të tokës të cilat janë parashikuar në VKM dhe janë detyrim ligjor.

Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit  
dhe Zhvillimit të Territorit

**Zhaneta Lubonja**

\_\_\_\_\_  
Drejtoresha e D.P.K.ZH.T.